



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-51

19.2.2026

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 datë 22.8.2025, Vendimin PA1 nr.08-43 datë 5.2.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.03.2019 dhe Konkluzionin, nr.ark.02-624/4 datë 18.2.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 7-të mbajtur më 18.2.2026, miratoi

Aktvendim
për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep.
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, ndalon së vlefshmi me ligj, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në pajtim me nenin 85, paragrafi (1) të LShMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në seancën e 5-të mbajtur më 3.2.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-418/5 datë 3.2.2026, miratoi Vendim PA1 nr.08-43 datë 5.2.2026, me të cilin i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.3.2019, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht sepse radiodifuzeri nuk ka përmblusur kushtet minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe për shkak se zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose të tjera.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LShMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë, Vendimi PA1 nr.08-43 datë 5.2.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë

Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNjP Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.3.2019 dhe Konkluzionin nr.ark.02-624/4 datë 18.2.2026, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 7-të mbajtur më 18.2.2026, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit,**

mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.